Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

2022

Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim"

Raporti vjetor

Tabela e Përmbajtjes

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim 2022

01 Hyrje

02 Rreth Organizatës

03 Projekte

04 Gratë në Fasoneri

05 POP 2022

06 GBWN

07 Dhuna me bazë Gjinore

08 Aleancat Mjedisore

09 Ajo Drejton

10 Kontakt

Hyrje

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim 2022

Viti 2022 për Qendrën "Aleanca Gjinore për Zhvillim" ka qenë një periudhë e mbushur me arritje dhe sfida të cilat kanë forcuar angazhimin tonë për avancimin e barazisë gjinore në shoqërinë shqiptare. Duke vazhduar misionin tonë të përkushtuar për të ndryshuar normat sociale dhe të kontribuojmë në krijimin e një mjedisi ku të drejtat dhe mundësitë e grave dhe vajzave janë të mbrojtura dhe respektuara, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim ka shënuar një vit të pasur me aktivitete dhe ndërhyrje të ndryshme.

Në këtë raport vjetor, do të hedhim një vështrim të hollësishëm mbi projektet, inicativat dhe rezultatet kryesore të vitit 2022, duke nxjerrë në pah impaktin tonë në fusha të ndryshme të zhvillimit dhe të drejtave të njeriut. Në një kohë kur sfidat për barazinë gjinore janë ende të shumta, ne vazhdojmë të angazhohemi në betejën për një shoqëri ku të gjitha individët, pavarësisht gjinisë, gëzojnë të njëjtat të drejta dhe mundësi.

Përmes projekteve inovative, kemi punuar në ndërtimin e një realiteti ku gratë dhe vajzat të ndihen të fuqizuara dhe të ndryshojnë komunitetet e tyre. Gjithashtu, kemi vazhduar përpjekjet tona në sensibilizimin e opinionit publik lidhur me sfidat dhe nevojat specifike të grave dhe vajzave në shoqërinë tonë.

Me këtë raport vjetor, synojmë të ndajmë me donatorët, partnerët dhe komunitetin në përgjithësi një perspektivë të detajuar mbi punën tonë dhe të kontribuojmë në dialogun e përbashkët për avancimin e të drejtave të grave dhe barabartinë gjinore.

Faleminderit për mbështetjen tuaj të vazhdueshme dhe besimin në misionin tonë për një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë.

Rreth Organizatës

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim 2022

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” (GADC) është një organizatë jo-fitimprurëse, e themeluar në vitin 1995 për barazinë midis grave dhe burrave në Shqipëri. Ajo synon krijimin e mundësive të barabarta midis gjinive nëpërmjet: informimit, studimeve, advokacisë, lobimit dhe trajnimeve, të trajtuara këto nën perspektivën gjinore.

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim është e mirënjohur në Shqipëri dhe në rajon, kjo falë një numri eventesh të zbatuar gjatë viteve, përfshirë analizë, monitorim, dhe vlerësim tëpolitikave dhe strategjive; programe trajnimi; ekzistenca e një ekipi trajnerësh në nivel kombëtar; organizim konferencash në nivel rajonal etj.

GADC vepron për të avancuar të drejtat e njeriut nga perspektiva e barazisë gjinore përmes veprimeve gjinore, zhvillimit të politikave dhe analizave me bazë gjinore.

“GADC është angazhuar në krijimin e një shoqërie ku të drejtat e njeriut nuk janë vetëm të garantuara, por edhe të promovuara dhe respektuara në çdo sferë të jetës”

Projekte

Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim 2022"

Fuqizimi i grave që punojnë në industrinë e veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri

Përmirësimi i kushteve të punës në sektorin e veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri dhe fuqizimi i grave që punojnë në këtë sektor.

Përballja e Ofertave Politike POP 2022

Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparenca.

Rrjeti mbikëqyrës i buxhetimit gjinor në Ballkanin Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë

Përmirësimi i pjesëmarrjen e OSHC-ve në proceset e politikave dhe buxhetimit në Evropën Juglindore dhe Republikën e Moldavisë duke përdorur raportimin dhe rrjetëzimin e mbikëqyrësit të buxhetimit gjinor.

Projekte

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim 2022”

Institucionalizimi i shërbimeve cilësore të rehabilitimit dhe integrimit për të mbijetuarat e dhunës

Cilësi e përmirësuar të shërbimeve për të mbijetuarat e Dhunës me Bazë Gjinore

Krijimi i Aleancave Lokale Feministe Mjedisore

Mbështetja e OSHC të grave lokale në avancimin e kapaciteteve të tyre dhe trajtimi në mënyrë efikase i çështjeve mjedisore nga perspektiva gjinore.

Ajo Drejton

Një projekt kushtuar Grave Shqiptare Sipërmarrëse

Gratë në fasoneri

Fuqizimi i grave që punojnë në industrinë e veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri.

Për shtatë vite radhazi, Qendra 'Aleanca Gjinore për Zhvillim' (GADC) ka ndërmarrë një projekt të mbështetur nga Olof Palme International Center dhe Qeveria Suedeze, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës për gratë dhe vajzat që punojnë në sektorin e tekstileve dhe këpucëve në Shqipëri. Projekti, i nisur me synimin e garantimit të respektimit të të drejtave të punës për këtë kategori, aktualisht quhet 'Përmirësimi i kushteve të punës në sektorin e veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri dhe fuqizimi i grave që punojnë në këtë sektor'. Ky transformim është rezultat i angazhimit të vazhdueshëm të GADC në rritjen e vëmendjes së aktorëve të rëndësishëm, shoqërisë dhe sidomos grave të punësura në fushën e veshjeve dhe këpucëve.



9 Sesione informuese me anëtarë të këshillave të shëndetit dhe sigurisë

340+ gra dhe vajza mësuan për numrin e gjelbër 0800 1818

8 çështje të përfaqësuara falas në gjykatë nga juristja e GADC

1 shkollë dimërore për anëtarët e këshillave të sigurisë dhe shëndetit në punë

2 tryeza të rrumbullakëta diskutimi

5 Fushata ndërgjegjësuese në rrjetet sociale



POP 2022

Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparenca

Fuqizimi i OSHC-ve për t'i mbajtur në mënyrë efektive përgjegjëse bashkitë për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale që lidhen me aksesin dhe angazhimin e qytetarëve në pushtetin vendor. Në vijim të projektit të vitit 2021 nga Rrjeti POP - Përballja e Ofertave Politike ku Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" është organizata lider, gjatë vitit 2022 u zhvillua projekti "Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparenca" me mbështetjen e Olof Palme International Center me fonde të Qeverisë Suedeze dhe National Endwoment for Democracy.

POP në shifra!

Të dhënat përfshijnë ecurinë e projektit në të gjitha bashkitë ku operon.

12 Bashki nën monitorim	**12** Organizata të Shoqërisë civile	**165** Mbledhje të Këshillit bashkiak të monitoruara	**17** Tryeza diskutimi me komunitetin	**165** Takime me përfaqësues të bashkive
31 Fokus Grupe Diskutimi	**5** Forume Publike	**1** Konferencë Kombëtare	**24** Raporte Monitorimi	**160.000** Persona kanë mësuar për POP

Projekti ka përfunduar vitin e katërt të implementimit, duke vazhduar të përdorë një metodologji interaktive që lejon adaptimet e nevojshme për të ndërhyrë në rezultate konkrete.

Konferenca Kombëtare "Rrjeti POP dhe kontrata sociale si mekanizma për transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve.



100% **Angazhim i organizatave partnere të Rrjetit POP për angazhimin qytetar dhe demokracinë vendore.**

GBWN

Rrjeti mbikëqyrës i buxhetimit gjinor në Ballkanin Perëndimor dhe Republikën e Moldavisë

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, në bashkëpunim me 6 organizata të tjera të Rajonit, implementoi projektin "Përmirësimi i pjesëmarrjen e OSHC-ve në proceset e politikave dhe buxhetimit në Evropën Juglindore dhe Republikën e Moldavisë duke përdorur raportimin dhe Rrjetin mbikëqyrës së buxhetimit gjinor" Projekti mbështetet nga Agjencia Austriake për Zhvillim.

01 Zgjerimi i Rrjetit

Projekti ka zgjeruar rrjetin rajonal, duke themeluar shtatë qendra të besueshme dhe duke intensifikuar bashkëpunimin me OSHC-të dhe qeveritë.

02 Trajnimi i OSHC-ve

Rrjeti Mbikëqyrës i Buxhetit Gjinor ka trajnuar mbi 100 OSHC dhe ka mentoruar 42 për përdorimin e mjeteve të BPGJ-së, duke prodhuar 36 raporte dhe iniciativa mbikëqyrëse.

03 Webinare dhe Seanca Dëgjimore

Organizuar 4 webinare dhe 10 seanca dëgjimore parlamentare për të ndërmjetësuar debate dhe shpërndarë informacion në nivel rajonal.

03 Akademia GBWN

Krijimi i akademisë online dhe një faqe interneti për të përmirësuar njohuritë dhe mobilizuar pjesëmarrësit për iniciativa buxhetore.

03 Monitorimi dhe Advokacia

Monitorimi i shpenzimeve buxhetore për barazinë gjinore dhe fokusimi në financimin e ndryshimeve klimatike për fazën e ardhshme të projektit GBWN.

Dhuna me bazë gjinore

Institucionalizimi i shërbimeve cilësore të rehabilitimit dhe integrimit për të mbijetuarat e dhunës

Projektit rajonal "Institucionalizimi i shërbimeve cilësore të rehabilitimit dhe integrimit për të mbijetuarit e dhunës" vijon që prej vitit 2019 dhe zbatohet në bashkëpunim me rrjetin e organizatave që punojnë kundër dhunës me bazë gjinore në vendet e Ballkanit Perëndimor, të udhëhequr nga Qendra Autonome e Grave, Serbi dhe mbështetet nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Projekti përfshiu rezultate si: 1) Mbështetja e grave për të lënë autorët e dhunës dhe për t'u bërë më autonome, 2) Propozime cilësore të bazuara në prova për legjislacionin sekondar dhe programe për të ndihmuar të mbijetuarat, 3) Përmirësimi i aftësive të ofruesve të shërbimeve në rritjen e mbrojtjes / sigurisë së të mbijetuarave, 4) Forcimin e rrjetit rajonal për adresimin e dhunës ndaj grave në përputhje me standardet e BE-së.

6 trajnime në qarqe të ndryshme (Korçë, Elbasan, Durrës, Vlorë, Shkodër dhe Tiranë) për ofruesit e shërbimeve publike dhe jopublike në ofrimin e shërbimeve cilësore për gratë dhe vajzat viktima të dhunës

4 Qendra Komunitare të Tiranës të monitoruara

2 raporte mbi shërbimet e rehabilitimit dhe riintegrimit për gratë e mbijetuara të dhunës brenda sistemit shqiptar të mirëqenies sociale

230 profesionistë nga institucione të ndryshme dhe Organizata të Shoqërisë Civile të trajnuar .



Fushata Advokuese (Arritje 2019-2022)

- Ligji për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, duke përfshirë 60% të rekomandimeve të ndryshimeve.
- Kodi Penal i Shqipërisë u ndryshua në vitin 2020 për të kriminalizuar dhunën psikologjike, duke përfunduar harmonizimin me Konventën e Stambollit me miratimin 100% të tre rekomandimeve.
- Vendimi nr. 327 i Këshillit të Ministrave në vitin 2021 për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve për raste të dhunës në marrëdhëniet familjare arriti miratimin 60% të rekomandimeve.
- Shqipëria ka hartuar tre protokolle të unifikuara për dhunën në familje dhe seksuale, duke përfshirë dhe situatat emergjente në pandeminë Covid-19.
- Strategjia e re Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 u miratua, duke integruar 30% të rekomandimeve nga organizatat e shoqërisë civile.
- Miratimi i ligjit për krijimin e regjistrit të autorëve të dhunës seksuale shënon një nismë të suksesshme në Shqipëri.

Aleancat Mjedisore

Mbështetja e OSHC të grave lokale në avancimin e kapaciteteve të tyre dhe trajtimi në mënyrë efikase i çështjeve mjedisore nga perspektiva gjinore.

Projekti "Krijimi i Aleancave Lokale Feministe Mjedisore", i zbatuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, është mbështetur nga Reactor - Research in Action dhe partnerët e tyre përmes Aksionit "Përparimi i Barazisë Gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE". Ky projekt u financua nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancua nga Suedia. Projekti u implementua në Pukë, Kamëz dhe Vlorë.

Projekti në shifra!

3 Bashki të përfshira	**6** Organizata të Shoqërisë civile	**531** Pjesmëmarrës në aktivitete	**24** Trajnime në Kamëz, Vlorë dhe Pukë	**19** Organizata të trajnuara
3 Fushata advokuese	**3** Raporte Monitoruese	**3** Aleanca Feministe të krijuara	**1** Dokument Politikash	**50.000** Persona kanë mësuar për Aleancat Mjedisore

Tryezë Diskutimi: "Aleancat Lokale Feministe Mjedisore"

Raporti Monitorues - Bashkia Vlorë
Raporti Monitorues - Bashkia Kamëz
Raporti Monitorues - Bashkia Pukë

100% **Angazhimi i Aleancave Lokale Mjedisore për advokaci në Pukë, Kamëz dhe Vlorë .**

Ajo Drejton

Një projekt kushtuar Grave Shqiptare Sipërmarrëse

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, zhvilloi projektin "Ajo Drejton" në periudhën 2021-2023, duke ju kushtuar fuqizimit të Grave Sipërmarrëse në Shqipëri, mbështetur nga Qeveria Hollandeze. Ky projekt transformues në Shqipëri, me një vizion të qartë dhe tre objektiva specifike, synonte të fuqizonte gratë sipërmarrëse duke krijuar një mjedis të përshtatshëm dhe duke adresuar pengesat financiare. Përmes edukimit, duke përfshirë seminare dhe uebinarë nëpër rrethe, projekti i pajisi gratë me mjetet për të orientuar në kompleksitetin e biznesit. Ndikimi i projektit shtrihet përtej politikave, dhe krijoi një rrjet dinamik bashkëpunimi.

Ajo Drejton në shifra!

Të dhënat përfshijnë ecurinë e projektit për vitin 2022

3 Tryeza Diskutimi	**10** Trajnime me gra në biznes	**2** Tryeza Diskutimi Rajonale	**1** Manual Trajnimi	**4** Seminare me gra në Biznes
2 Webinare Rajonale	**4** Module Trajnimi	**1** Raport Vlerësues	**300** Përfituese të trajnimeve	**60.000** Persona kanë mësuar për Ajo Drejton

Projektido të vijojë edhe gjatë vitit 2023 me lehtësimin e një platforme për rrjetëzimin kombëtar dhe rajonal midis grave sipërmarrëse. Duke krijuar lidhje dhe duke nxitur bashkëpunimin, dhe duke parashikuar rrugë të reja për zhvillimin dhe zgjerimin e biznesit në të gjithë Shqipërinë.

Manuali i Trajnimit: Gratë në Sipërmarrje, Financat dhe Sistemi Tatimor
Raporti Kërkimor: Vlerësimi i Mjedisit për Sipërmarrjen e Grave: Një Vëzhgim mbi Sipërmarrjen e Grave në Shqipër

100%

Angazhim i Aleancës Gjinore për Zhvillim për fuqizimin e grave dhe vajzave sipërmarrëse.

Konkluzione

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim 2022

01 Gratë dhe Vajzat në Fasoneri

Projekti ka ka përmirësuar kushtet e punës për gratë dhe vajzat në industrinë e tekstileve dhe këpucëve, duke garantuar respektimin e të drejtave të punës dhe duke sjellë një transformim të rëndësishëm në këtë fushë.

02 POP - Kontrata Sociale

Ka fuqizuar OSHC-të në përgjegjësitë e tyre për të mbajtur bashkitë përgjegjëse për Kontratën Sociale, duke përmirësuar aksesin dhe angazhimin e qytetarëve në vendimmarrjen vendore.

03 GBWN

Ka trajnuar OSHC dhe ka ndikuar në politikat buxhetore në nivel lokal dhe kombëtar, duke kontribuar në përparimin e arritjes së treguesve të SDG 5c1.



04 Institucionalizimi i Shërbimeve

Ka sjellë rezultate të rëndësishme duke mbështetur gratë për të lënë autorët e dhunës dhe duke përmirësuar aftësitë e ofruesve të shërbimeve.

05 Krijimi i Aleancave Mjedisore

Ka mbështetur OSHC të grave në avancimin e kapaciteteve të tyre dhe trajtimin efikas të çështjeve mjedisore nga perspektiva gjinore, duke promovuar pjesëmarrjen e tyre aktive.

06 Ajo Drejton

Ka ndikuar në fuqizimin e grave sipërmarrëse në Shqipëri duke krijuar një mjedis të përshtatshëm dhe duke adresuar pengesat financiare, duke ndihmuar në krijimin e një rrjeti dinamik bashkëpunimi.

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, duke kryer projekte inovative dhe përmirësuese, ka shpërfaqur një angazhim të palëkundur në fuqizimin e grave në Shqipëri në fusha të ndryshme, përfshirë të drejtat e punës, pjesëmarrjen qytetare, buxhetimin gjinor, rehabilitimin e viktimave të dhunës, dhe fuqizimin e grave sipërmarrëse. Me një qëllim të qartë për avancimin e barazisë gjinore dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për gratë dhe vajzat, Aleanca Gjinore për Zhvillim ka ndikuar pozitivisht në shoqërinë shqiptare.

Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim Raporti Vjetor 2022

Kontakt

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”
Adresa: Rr."Abdyl Frasheri”, P.10/1, Tirana, Albania P.O Box 2418

Tel: +355 4 22 555 14
Cel: +355 68 20 59 301

Web: https://gadc.org.al/
E-mail: gadc@gadc.org.al

https://www.facebook.com/GADCAlbania
https://www.instagram.com/gadc_albania/
https://twitter.com/GADC_AI
https://www.youtube.com/channel/UCUZJnKqwQ0cURSqKPc1NaXQ